



**#DITA BOTËRORE E LIBRIT NË SHTËPINË E FËMIJËS “ZYBER HALLULLI”**



Librat janë miqtë më besnikë të fëmijëve dhe një pasuri shumë e madhe për të gjithë shoqërinë.

Këtë vit, Dita Botërore e Librit na gjeti pranë Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë “Zyber Hallulli”. Shërbimi Social Shtetëror organizoi një aktivitet i cili theksoi rëndësinë e librave dhe leximit tek formimi i fëmijëve. Pjesë e aktivitetit ishte edhe pasurimi i bibliotekës së institucionit me libra të rinj të llojeve të ndryshme, të cilat fëmijët po presin me padurim t’i lexojnë në kohën e lirë.

**#PUKË, PËRKRAHJA PËR FËMIJËT E MBETUR JETIMË**



Mbrëmjen e 9 Prillit një zjarr i papritur në banesë shkaktoi largimin e parakohshëm nga jeta të prindërve të 4 fëmijëve nga Puka. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër vizitoi menjëherë fëmijët dhe gjyshërit për të lehtësuar sado pak dhimbjen e tyre.

Familja u ndihmua me ushqime, veshmbathje dhe mjete të tjera për banesën. Përveç ndihmës së menjëhershme, u morën masa për të përcaktuar sa më shpejt familjen kujdestare për 4 fëmijët. Gjithashtu gjyshja e paralizuar e fëmijëve u asistua në plotësimin e dosjes për përfitimin e statusit të para-tetraplegjisë, si edhe iu dhurua një karrocë e re për t’i lehtësuar lëvizjen.




**SHERBIMI SOCIAL**

## #DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka kryer kontroll në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier lidhur me zbatimin e legjislacionit për Ndhmën Ekonomike për periudhën Mars 2018-Mars 2019.

Janë monitoruar kontrollat e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark.

Për 12 Drejtoritë Rajonale është monitoruar procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes.



## #DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Prill, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer 30 vlerësime social-ekonomike të fëmijëve të pashoqëruar si edhe janë riatdhësuar 10 fëmijë të pashoqëruar, për të cilët është koordinuar puna për pritjen në aeroport. Janë menaxhuar 2 raste VT/VMT dhe viktimat të dhunës në familje.

Komisioni për Fëmijët ka shqyrtuar dokumentacionin dhe ka sistemuar në IPSH 2 fëmijë, ndërsa 1 fëmijë tjetër është transferuar. Është sistemuar një fëmijë me aftësi të kufizuara në IPSH.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, ku janë rinovuar 56 librezat dhe e kanë përfituar për herë të parë këtë status 51 jetimë.

Gjatë muajit Prill Komisioni për të Moshuarit ka komisionuar 14 të moshuar për t'u sistemuar në IPSH.





#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Në Shtëpinë e Foshnjës “Hannah dhe Rozafa” është zhvilluar festa e lamtumirës për një foshnjë e cila është birësuar dhe ka tashmë një vatër të ngrohtë familjare në Kanada.

Çdo fëmijë meriton një familje dhe këto raste tregojnë gjithnjë e më tepër se si ka marrë jetë procesi i de-institucionalizimit, i cili për ne është proces shumë i rëndësishëm.

Prindërit birësues të foshnjës kanë qënë mbështetës të vazhdueshëm të institucionit. Edhe në këtë ditë ata kanë dhuruar medikamente dhe dhurata për të gjithë foshnjat e tjera, si edhe kanë dhënë kontributin e tyre në rinovimin e një ambienti të institucionit.

Vogëlush shumë urime dhe jetë të lumtur pranë familjes tënde të re e të bukur!

#PANAIRI I IDEVE NË DURRËS

Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës u prezantua në “Panairin e Ideve” me punimet e fëmijëve përfitues.

Në këtë aktivitet u paraqitën punimet e fëmijëve me aftësi ndryshe në fusha të tilla, si: pikturat, skulptura dhe punime të tjera krijuese me dorë.

Të gjithë fëmijët që marrin shërbime pranë Qendrave tona të Zhvillimit ndjekin një program të rregullt me terapi, pjesë e së cilave janë edhe këto punime artistike.

